**Organization for Security and Co-operation in Europe**
Office for Democratic Institutions and Human Rights

Ul. Miodoëa 10
00-251 Ëarsaë, Poland

Tel: +48 22 520 06 00
Fax: +48 22 520 06 05

E-mail: bpri@odihr.pl
**osce.org/odihr**

# Raporti nga Seminari rajonal për pjesëmarrjen politike të Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve

Shkup, 22-23 nëntor 2013

Projekti "Praktikat më të mira për integrimin e romëve" mblodhi së bashku 28 gra rome nga rajoni i Ballkanit Perëndimor për një seminar dy-ditor për të mbështetur shkëmbimin e përvojës në lidhje me pjesëmarrjen politike. Në takim u përfshin edhe pjesëmarrës të tjerë nga UN Women në Shkup, Programi i Përbashkët i Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve, Delegacioni i Finlandës në Sekretariatin e OSBE-së në Vjenë, Misioni i OSBE-së në Shkup dhe të tjerë.

Seminari rajonal bazohej në një takim përgatitor të grave rome të mbajtur gjatë takimit të Dimensionit njerëzor të OSBE-së (HDIM) që u mbajt shtatorin e kaluar në Varshavë, Poloni. Projekti BPRI shfrytëzoi rastin për të diskutuar tema me interes për vazhdimësinë e aktiviteteve. Gratë Rome shprehën interesin e tyre për pjesëmarrjen politike, në veçanti, për rrjetëzimin, mentorimin dhe vendim marrjen. Këto tema specifike u përdorën si bazë për seminarin rajonal.

Rrjetet e grave rome janë themeluar në disa vende të Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë Bosnjë dhe Hercegovinën[1], Malin e Zi[2], Serbinë dhe Kosova[*]. Qëllimi i punëtorisë rajonale ishte të forcohen kapacitetet e këtyre rrjeteve dhe t'u mundësohet të shkëmbejnë përvojat ndërmjet tyre dhe me OJQ-të e tjera të grave rome në nivel rajonal.

BPRI është një projekt rajonal i financuar nga Bashkimi Evropian, i mbështetur nga shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së dhe që zbatohet nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut. Projekti promovon pjesëmarrjen më të madhe rome në jetën politike dhe publike dhe vendimmarrjen, akces më të madh ndaj ndihmës juridike dhe kushteve më të mira të jetesës.

[1] Akoma nuk është e regjistruar me ligj.
[2] Në Mal të Zi, Rrjeti i grave rome është formuar nga *aktivistet* fillimisht nga shtatë qytete, ndërsa në shtetet tjera rrjetet përbëhen nga *organizata* të Grave Rome.
[*] Ky përcaktim është pa paragjykim për pozitën apo statusin, dhe është në vijë me RKSKB 12/44 dhe mendimin e GJND-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

*Fjalë mirëseardhjeje*

Sh.T. Ralf Breth, shef i Misionit të OSBE-së në Shkup, shprehu kënaqësinë e tij se projekti BPRI zhvillon Seminarin rajonal në vendin nikoqir. Ai përsëriti gjithashtu se pavarësisht nga miratimit i Planit të Veprimit për Përmirësimin e Statusit të Grave Rome, në vend për fat të keq nuk ka përparim të dukshëm në drejtim të pjesëmarrjes më të madhe të grave rome në jetën publike dhe politike. Ambasadori Breth më tej shprehu besimin e tij se projekti BPRI do të promovojë programe të reja dhe do të lehtësojë bashkëpunimin mes qeverive lokale dhe kombëtare, institucionet e pavarura dhe shoqërisë civile.

Znj Mabera Kamberi, nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, nënvizoi rëndësinë e Lobit të Grave që ngriti me sukses çështjet e barazisë gjinore në agjendën politike kombëtare. Të drejtat e grave rome u përfshinë në Planet e Veprimit të Strategjisë Kombëtare të miratuar nga qeveria në vitin 2011 dhe Ligji për arsim të mesëm ndihmoi në rritjen e nivelit të arsimit duke e bërë arsimin e mesëm të detyrueshëm. Zonja Kamberi shprehu shpresën se gratë rome do të kandidohen në zgjedhjet e ardhshme në vitin 2013, por gjithashtu paralajmëroi për rrezikun e premtimeve të rreme.

*Znj. Kamberi foli për përvojën e saj personale si grua Rome e punësuar*

Znj Milena Isakoviç, Koordinatore Rajonale e BPRI, shpjegoi rëndësinë e pjesëmarrjes së grave rome për suksesin e (çdo) projekti dhe inkurajoi aktivistet më me përvojë të mbështesin koleget e tyre të reja gjatë seminarit dhe në aktivitetet vijuese.

*Investimi në rrjetet si një vegël avokimi*

Në seminarin rajonal u bënë prezantime nga rrjetet e grave në Bullgari, Hungari dhe vendit nikoqir. Znj Daniela Kollarova, Drejtor Ekzekutiv e Fondacionit Partners Bulgaria, prezantoi aktivitetet e tyre në fushën e planifikimit bashkëpunues në bashkësitë rome, avokimit me autoritetet lokale dhe një program lidershipi në 13 qytete. Znj Eva Deak, Drejtore Ekzekutive e Partners Hungari, diskutoi me pjesëmarrësit aftësinë e organizatave për të ndikuar në hartimin e politikave në nivel kombëtar. Ata diskutuan gjithashtu përfitimet dhe qëndrueshmërinë e programeve të ndërmjetësimit shëndetësorë, ku femrat rome kanë luajtur një rol vendimtar.

Pjesëmarrësit gjithashtu kishin mundësinë të njoftohen me krijimin e Rrjetit Kombëtar për t'i dhënë fund dhunës kundër grave dhe dhunës në familje në vendin nikoqir. Znj Elena Dimushevska, Drejtore Ekzekutive e këtij rrjeti, prezantoi kuadrin e vendosur me mbështetjen e UN Women duke përfshirë edhe rregullat e procedurës, politikat e komunikimit dhe regjistrimin ligjor të rrjetit. Ky rrjet nuk ofron shërbime të drejtpërdrejta për viktimat e dhunës, por ofron trajnime për organizatat anëtare për të përmirësuar

cilësinë e shërbimeve të tyre. Ata gjithashtu kanë kryer një shqyrtim të kapaciteteve të organizatave anëtare dhe kanë identifikuar rajonet në vendin ku nuk ka OJQ që punojnë në fushën e luftës kundër dhunës në familje. Rrjeti do të punojë për të plotësuar këto boshllëqe dhe merr pjesë në hartimin e politikave në nivel kombëtar, duke përfshirë edhe hartimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Dhunës në Familje 2012-2015.

*Znj. Harapi foli për përpjekjet e grave Rome në Shqipëri*

Në grupet e diskutimit, gratë rome theksuan se besimi i ndërsjellë, aktivitete transparente, rregulla të qarta, objektivat dhe vlerat e përbashkëta janë themeli i një rrjeti të suksesshëm. Rëndësia e grumbullimit të suksesshëm të fondeve dhe një grupi të organizatave udhëheqëse /koordinuese nuk duhet të neglizhohet. Disa rrjete janë në gjendje të sigurojnë lehtësimin profesional, ndërsa të tjerët përdorin një strukturë më pak formale.

Përveç kësaj, pjesëmarrësit theksuan se mekanizmat për zgjidhjen e konflikteve janë thelbësorë për mbijetesën afatgjatë të rrjetit. Një kod i etikës mund të jetë një instrument i dobishëm për zgjidhjen e situatave konfliktuoze dhe rivendosjen e solidaritet. Në Bosnjë dhe Hercegovinë, anëtarët e rrjetit kanë themeluar një grup punues që ndërmjetësoi në gjetjen e një zgjidhjeje të cilën më pas ua komunikojë të gjithë anëtarëve.

Çështja e anëtarëve joaktivë është gjithashtu një pengesë me të cilën përballen rrjetet e grave rome. Rrjeti i lartpërmendur për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje pezullon anëtarët të cilët gjashtë muaj nuk përgjigjen në mesazhet. Ky rregull ka ndihmuar për të inkurajuar pjesëmarrjen dhe për të rritur përkushtimin e anëtarëve.

Kuadri ligjor në Ballkanin Perëndimor nuk është shumë i përshtatshëm për krijimin e rrjeteve. Në veçanti, problem paraqet fakti se në qoftë se bllokohet llogaria bankare e një anëtari të organizatës, i gjithë rrjeti bllokohet financiarisht. Megjithatë, disa pjesëmarrës e panë të arsyeshme dhënien e një forme ligjore për rrjetin e tyre që aktivitetet e përbashkëta të mund të zbatohen në mënyrë më efikase.

*Mentorimi*

Në Ballkanin Perëndimor ekzistojnë disa programe mentorimi (shih seksionin e burimeve me poshtë). Aspektet kyçe të programeve të suksesshme të mentorimit përfshijë njohuri teknike në fushën e caktuar, një ndjeshmëri, aftësi dhe përvojë në programet e mentorimit, si dhe komunikimin e mirë. Problemet ndodhin nëse përfituesi ndjen se mentori i tij nuk është me përvojë të mjaftueshme.

Ecja e Mentorimit që u organizua në zonën kryesore këmbësore në Beograd, Serbi, dhe qytete të tjera në rajon është një nga mënyrat për të rritur ndërgjegjshmërinë në lidhje me rëndësinë e programeve të mentorimit.

*Përdorimi i Mediave sociale për të promovuar barazinë gjinore dhe për të fuqizuar gratë rome*

Znj Jelena Saviq, aktiviste e re nga Serbia, diskutoi me pjesëmarrësit se si organizatat e tyre përdorin mediat sociale. Shumica e aktivistëve përdorin Facebook-un, ndërsa disa organizata gjithashtu paraqitën rezultatet e tyre në ueb faqe. Twitter dhe Youtube janë më pak të njohura. Mediat sociale janë me qasje më të lehtë dhe mund të ndikohen më lehtë sesa mediat tradicionale për të ndikuar mbi mediat tradicionale, por edhe organizatat më të fuqishme përballen me sfida në komunikimin e arritjeve të tyre, sidomos në gjuhën angleze apo të tjera.

Ekzistojnë gjithashtu edhe rreziqe në përdorimin e medieve sociale pasi kjo mund të hap mundësinë për komente negative dhe fyerje ndaj organizatës. Mbajtja e domenit publik kërkon shumë punë (qoftë seksioni i komenteve në ueb faqe ose faqja e Facebook-t).

Në seminarin u paraqitën dy video - një i prodhuar nga projekti BPRI për të treguar gratë rome të cilat u kandiduan në zgjedhjet lokale në Bosnje dhe Hercegovinë. Edhe pse gratë rome nuk patën sukses në këto zgjedhje, ato tashmë po përgatiten për zgjedhjet që do të mbahen pas katër vjet.

*Znj. Delija prezantoi mbrojtjen që ofron Qendra për Iniciativat Rome kundër martesave të hershme dhe të detyruara në Mal të Zi*

Video e dytë është prodhuar nga Qendra për Nisma Rome nga Mali i Zi, që paraqet një histori tronditëse të një gruaje rome të cilën e kishin detyruar të martohej në një moshë shumë të re. Pas organizimit të karvanit të grave rome të cilët pranuan të flasin publikisht për përvojën e tyre në një martesë të detyruar, kjo organizatë tani është në kërkim të partnerëve dhe ideve për të vazhduar aktivitetet në 2013.

Në ditën e dytë të seminarit, pjesëmarrësit kishin mundësi të praktikojnë regjistrimin e prezantimit të tyre personal me udhëzim nga z Dushko Arsovski, nga RTV e Maqedonisë dhe ish shefi i Zyrës të Shërbimit botëror të BBC në Shkup. Ata u përqendruan në atë se si të paraqesin punën e organizatës së tyre dhe aktivitetet e tyre të avokimit në media.

*Vendimmarrja dhe Pjesëmarrja Politike*

Grupet punuese për vendimmarrje dhe pjesëmarrje politike u moderuan nga z Vlladimir Llazovski dhe z Aleksandar Krzhallovski nga Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QMBN).

Ka lloje të ndryshme të pushtetit që mund të shfrytëzohen në procesin e pjesëmarrjes politike. Trajnerët u fokusuan në veglat e ndryshme që OJQ-të kanë në dispozicion për të komunikuar prioritetet. Pasi u ilustruan disa shembuj të përpjekjeve të suksesshme dhe të dështuara të pjesëmarrjes politike të femrave dhe grave rome në mënyrë specifike, pjesëmarrësit diskutuan çështjet e mëtejshme (1) Si të arrihet pjesëmarrje më e madhe e grave rome në politikë dhe në vendim-marrje?; (2) Cilat janë 'përvojat personale dhe të organizatave në këtë fushë?, (3) Cilët janë faktorët që kanë ndikuar në suksesin (ose dështimin) e përpjekjeve të pjesëmarrësve në nivel lokal apo kombëtar? dhe (4) Çfarë rekomandime mund të identifikohen për të ardhmen?

Pjesëmarrësit u përqendrua në identifikimin e faktorëve që kontribuuan drejt suksesit dhe dështimit të përpjekjeve për pjesëmarrje politike në vendet e tyre dhe u përpoqën t'i përmbledhin ato në disa kategori të mëdha. Faktorët e suksesit përfshijnë:

- Prania e bashkëpunimit strategjik dhe vendosja e aleancave me partnerët përkatës;
- Bashkëpunimi i grave rome me OJQ-të dhe partitë politike kryesore (rome dhe jo-rome);
- Krijimi i sistemeve të ndërtimit të kapaciteteve që do të ofrojnë trajnim dhe mentorim të vazhdueshëm;
- Krijimi i programeve që do të zhvillojnë ndjeshmërinë gjinore në mesin e udhëheqësve politikë;
- Disponueshmëria e bursave të shkencave politike për gratë rome dhe
- Mbështetja nga Qeveria.

Mekanizma që mundësojnë pjesëmarrjen e grave rome në vendimmarrje përfshijnë debat publike në parlamentet apo kuvendet komunale, ditë të hapura në qeveri apo parlament, platforma të qytetarëve, debate publike për projekt ligjet, Këshillat e Minoritetit Rom, raportet nën hije rreth zbatimit të CEDOW dhe konventat e tjera, rishikimi i Planeve Kombëtare të Veprimit për Romët, etj. Megjithatë, grave rome shpesh u mungojnë informacione në lidhje me këto mundësi apo komentet e tyre nuk merren seriozisht nga hartuesit e politikave.

Burime

- Takimi i Dimensionit Njerëzor i OSBE-së, http://www.osce.org/hdim_2012
- Qendra për Iniciativa Rome, Mali i Zi, http://www.crink.me/
- Programi i përbashkët për mbrojtje të minoriteteve të Këshillit të Evropës, http://www.jp.coe.int/CEAD/JP/Default.asp?TransID=209
- Rrjeti kombëtar për t'i dhënë fund dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, http://www.glasprotivnasilstvo.org.mk/
- Rrjeti i grave rome, http://www.romawomeninfo.com/?lang=en
- Qendra Rome e Informimit "Kali Sara", Sarajevë, Bosnia dhe Hecergovina, http://bhric.ba/?page_id=7
- Ballkan Sunflowers, Kosovë, http://www.balkansunflowers.org/
- Shoqata e grave rome "Ardhmëri më e mirë", Tuzlla, Bosnia dhe Hercegovina, http://www.bolja-buducnost.com.ba/infusions/fusion_tube/view.php?cat_id=2&video_id=3
- Aktivi Rom Shqipëri: http://romayouth.com/albania-roma-active-albania

- Fondacioni Partners Bulgaria, http://www.partnersbg.org/
- Partners Hungaria, http://www.partnershungary.hu/en/
- Programi i Mentorimit Rom Versitas, http://www.osi.hu/exhibition/macedonia.html
- Lobi i grave në Shkup, http://www.rwlsee.org/index.html
- Programi i Mentorimit i Fondit për arsimin të romëve për punonjësit shëndetësorë, http://www.mc.rs/stipendije-za-ucenikeice-i-studentkinje-romske-nacionalnosti-za-obrazovanje-u-oblasti-medicinskih-nauka.3137.html
- http://www.romaeducationfund.hu/scholarship-apply-serbian
- Misioni i OSBE-së për programin e Serbisë "Ndaje njohurinë tënde, bëju mentor" (në bashkëpunim me Lëvizjen Evropiane në Serbi), http://www.emins.org/emins_english/content/02_activities/projects/share_your_knowledge/index.html
- Rrjeti i Studenteve Rome në Universitetin e Novi Sadit, Serbi – ju lutemi kontaktoni znj. Marina Simeunoviq në marina_simeunovic@yahoo.com
- Forumi Evropian i Romëve dhe Udhëtarëve, http://www.ertf.org/
- Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar, http://www.mcms.org.mk/en.html

Shembuj të mediave dhe rrjeteve sociale

- OJQ e grave rome "Zemra rome" nga Kroacia:
  - Faqe në Facebook: http://www.facebook.com/pages/Udruga-%C5%BEena-Romkinja-Romsko-srce/296671939813
  - Video prezantim në Youtube: http://www.youtube.com/watch?v=LAH9Eenzz_k
- Faqja në Facebook e Shoqatës Romani Cej: http://www.facebook.com/romskadjevojka.romanicej
- Si ndihmojnë mediat sociale në rimëkëmbjen nga uragani Sendi
- http://www.buzzfeed.com/annanorth/hoë-social-media-is-aiding-the-hurricane-sandy-rec
- Projekti i lirisë i CNN-it, http://thecnnfreedomproject.blogs.cnn.com/
- Vlerëso mjekun tënd, http://kakavjedoktor.srbijaupokretu.org/
- Wikileaks, http://wikileaks.org/
- Anonimus Occupy Wall Street, http://occupywallst.org/
- http://romaëoman.org/?page=mission
- Lista e adresave për Rrjetin virtual Rom, http://www.valery-novoselsky.org/romavirtualnetwork.html
- 33 lista të adresave elektronike në 20 gjuhë (përfshi edhe në gjuhën rome) me anëtarësi prej mbi 12,100 e-mail adresa: romano_liloro@googlegroups.com
- Komiteti i planifikimit të Konferencës të 4 të grave rome, http://www.facebook.com/groups/romnialution/
- Blogje:
  - Feministe Rome, http://usernameka.wordpress.com/
  - 25ditë, http://twentyfivedays.wordpress.com/

- Vizatime komike:
    - Masa afirmative, http://www.pixton.com/comic/qijel527
    - Përjashtim majtist, http://stripgenerator.com/strip/639368/lets-make-a-difference/
    - Filozof, http://stripgenerator.com/strip/564064/serbian-philosopher-making-a-point/view/all/
    - Feminist, http://stripgenerator.com/strip/494040/feminist-view/